

Kontabiliteti i menaxhmentit – Testi 2

1. Kompania përgatitë pasqyrën e të ardhurave sipas metodës variabile për nevoja të raportimit të brendshëm, ndërsa sipas metodës absorbuese për nevoja të raportimit të jashtëm. Për vitin e parë të operimit, kompania përgatitë pasqyrën vijuese të të ardhurave sipas përllogaritjes variabile:

Shitja (225 njësi x 1.600 €)	€ 360.000
Kostot variabile të prodhimit (225 x 625 €)	€ 140.625
Shp. variabile të shitjes dhe adm. (225 x 65 €)	€ 14.625
Marzha e kontributit	€ 204.750
Kostot fikse indirekte	€ 56.250
Fikse të shitjes dhe administratës	€ 75.000
E ardhura neto	€ 73.500

Gjatë vitit janë prodhuar 375 njësi dhe janë shitur 225, duke mbetur 150 njësi në inventar përfundimtar.

1. Përgatit pasqyrën e të ardhurave për vitin vijues sipas përllogaritjes absorbuese,
 2. Shpjego dallimin në të ardhurën e konstatuar me përllogaritjen variabile.
2. Kompania gjatë vitit prodhon 44.000 njësi dhe shet 36.000 njësi me çmim 140 € për njësi. Të dhënat janë:

Materiali direkt	60 € për njësi
Puna direkte	22 € për njësi
Kostot indirekte variabile	8 € për njësi
Kostot totale fikse indirekte	528.000 €
Shpenzimet variabile të shitjes dhe administr.	11 € për njësi
Shpenzimet fikse të shitjes dhe administr.	105.000 €

Nën supozimin se kompania përdorë përllogaritjen absorbuese, të llogaritet kosto për njësi dhe të përgatitet pasqyra e të ardhurave.

3. Kompania prodhon dyer dhe dritare nga materiali i plastikës. Shitja e saj dhe kostoja e buxhetuar për nëntor 20x2 është si vijon:

Materiali direkt (plastika)	0,50 kg x 70 €
Puna direkte	0,75 orë x 8 €

Rezultatet aktuale të kompanisë janë:

Materiali direkt (plastika)	2.800 x (0,50 kg x 72 €)
Puna direkte	2.800 x (0,70 orë x 8,20 €)

Kërkohet të kalkuloni:

- a. Shmangien e sasisë dhe çmimit të materialit,
- b. Shmangien e sasisë dhe çmimit të punës direkte,

4. Prodhimi i produktit kërkon 0,80 € standarde të punës direkte për njësi, me çmimin standard të punës për një orë prej 6,75 €. 2,000 njësi të prodhuara, aktualisht kërkojnë 1.580 orë të punës me kosto 6,90 € për orë. Kërkohet të kalkulohet:

- ✓ Shmangia e çmimit të punës,
- ✓ Shmangia e efijencës apo shmangia e sasisë së punës,
- ✓ Çfarë janë regjistrimet e shmangieve në kontabilitet.

5. AA Electric ka pranuar një ofertë për të blerë 20.000 njësi me çmim prej 65 € për njësi, të cilat kompanisë tani i kushtojnë 75 €. Kostot e prodhimit të 20.000 njësive janë: MD 450,000 €, PD 225,000 €, kostot indirekte variabile 450,000 €, ato fikse indirekte 375,000 €. Të gjitha kostot fikse indirekte, përveç 250,000 €, do të shmangen nëse blihet produkti. Çfarë duhet bërë kompania në këtë rast?

6. Kompania ka tri departamente. Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave është si vijon:

	Departament A	Departament B	Departament C	Total
Shitja	€ 300,000	€280,000	€150,000	€730,000
KV	160,000	175,000	130,000	465,000
MK	140,000	105,000	20,000	265,000
KF	65,000	35,000	50,000	150,000
E ardhura neto	75,000	70,000	(30,000)	115,000

Nëse departamenti C mbyllet, 32.000 € nga kostot fikse do të eliminohen, ndërsa pjesa tjetër do të mbetet. Me këtë rast, shitja në Departamentin A do të ulet për 5 %, ndërsa e departamentit B do të rritet për 10 %. A duhet mbyllur departamenti C apo jo?

7. Firma ka te dhënat vijuese për prodhimin dhe shitjen e 20.000 njësive për muaj.

Prodhimi:	
MD	€2.00
PD	4.00
Kosto variabile indirekte	1.00
Kostot fikse indirekte	1.80
Shpenzimet e shitjes dhe administratës:	
Variabile	3.00
Fikse	1.200

Supozojmë se firma ka 100 njësi te pa shitura nga viti i kaluar te cilat kanë një defekt te vogël dhe te cilat do te shiten me çmim me te ulet si hedhurine. Kjo nuk do te ketë efekt ne shitjen tjetër të firmës. Kostot variabile te shitjes dhe administratës do te na paraqiten edhe me rasti ne kësaj sasive me defekt. Cilat kosto janë relevante me rastin e përcaktimit te çmimit minimal për shitjen e këtyre njësive?

8. Kompania, në kushte normale, shet 10.000 njësi të produktit të saj me çmim prej 20 € për njësi. Kostot të cilat e përcjellin secilin produkt janë: variabile 10 € për njësi dhe fikse 30,000 €. Një distributor nga jashtë, dëshiron të blejë 200 njësi për 15 € për njësi. Kompania ka kapacitete të pashfrytëzuara, mirëpo me qëllim të prodhimit të sasisë së kërkuar, duhet të merr me qira pajisje shtesë për të cilat paguan 2,000 €. Për t'u marrë parasysh pranimi apo mospranimi i ofertës speciale, cilat nga kostot janë relevante:
- Kostot variabile prej 10 € të cilat duhet mbuluar,
 - Kostot fikse prej 32,000 € të cilat duhet mbuluar,
 - Kostot fikse prej 2,000 € të cilat duhet mbuluar,
 - Si nën a ashtu edhe nën b,
 - Si nën a shtu edhe nën c.
9. Një studim ka treguar se nje nga departamentet e firmes, duhet te mbyllet. Marzha e kontributit në këtë departament është 150.000 € për tërë vitin, ndërsa kostot fikse që e ngarkojnë departamentin e njëjtë janë 195.000 €. Eshte vleresuar se 120.000 € e ketyre kostove fikse mund te eliminohen nese departamenti mbyllet. Keto te dhena tregojne se, nese departamenti mbyllet, fitimi I teresishem I firmes do te:
- zvogelohet per 30.000 € ne vit,
 - rritet per 30.000 € ne vit,
 - zvogelohet per 75.000 € ne vit,
 - rritet per 75.000 € ne vit.
10. Firma mund të prodhojë 100 njësi me kosto vijuese: MD 80,000 €, PD 13,000 €, kostot variabile indirekte 40,000€, kostot fikse indirekte 27,000 €. Nëse firma mund të blejë produktin në tregun e jashtëm, 4,000 € nga kostot fikse mund të shmangen, ndërsa produkti mund të blihet për 145,000 €. Çfarë është vendimi i drejtë:
- Prodho dhe kurse 8,000 €,
 - Blej dhe kurse 8,000 €,
 - Prodho dhe kurse 20,000 €,
 - Blej dhe kurse 20,000 €.
11. Firma prodhon 1.200.000 kondicioner ajri ne vit me kosto variabile prej 13.000.000 € dhe kosto fikse 1.800.000 €. Bazuar ne parashikimin e firmës për vitin e ardhshëm, 960.000 kondicioner mund te shiten me çmim të rregullt prej 20 € secili. Po ashtu, firma ka pranuar një porosi speciale për 240.000 kondicioner për t'u shitur me 70% te çmimit te rregullt. Kostot totale fikse nuk do te ndikohen nga kjo porosi. Cila nga shumatat do të rritë të ardhurën neto operative të firmës, nëse pranohet porosia speciale:
- 480.000 €
 - 600.000 €
 - 768.000 €
 - 844.000 €
12. Kompania X merret me perpunimin e drurit per prodhimin e kornizave te dritareve. Cmimi kushtues i nje kornize eshte 100€ dhe prodhon gjithsej 1000 cope. Korniza mund të shitet pa ndonjë përpunim të mëtejshëm për 110€, apo mund të përpunohet tutje dhe të shndërrohet ne dritare cila mund te shitet per 125€ për copë. Përpunimi I mëtejshëm do të mbaje rrezikun me vete se gjate përpunimit të 1.000 dritareve zakonisht vie deri te shkatërrimi I 100 copë kornizave. Të merret vendimi të shiten apo të përpunohen.